UDHËZIM
Nr.15, datë 18.6.2010

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TIP TË KËRKESËS, PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN DHE FORMULARIT TË TË DHËNAVE, PËR NJËSITË E NDËRTUARA NË ZONAT E STIMULUARA, ME PËRPARËSI TURIZMIN

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 4 germa a, 5 germa a dhe nenit 7 pika 1 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

1. Kërkesat e subjektit të interesuar/personit të stimuluar, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, paraqiten respektivisht sipas formularit 1 dhe formularit 2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe përmbajnë:

a) Gjeneralitetet e subjektit të interesuar/personit të stimuluar, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin.

b) Të dhëna mbi marrëveshjen e qirasë/zhvillimit.

c) Vendndodhjen e njësisë së ndërtuar dhe emërtimin e zonës së stimuluar.

d) Të dhënat ndërtimore të njësisë së ndërtuar, si dhe të dhëna të tjera lidhur me funksionin dhe sipërfaqen e truallit për të cilën kërkohet kalimi i së drejtës së pronësisë.

e) Dokumentacionin që disponon subjekti i interesuar/personi i stimuluar, në përputhje me kërkesat e nenit 4 dhe 5 të ligjit nr.10 186/2009:

i) kontratën e lidhur me personin e stimuluar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar (vetëm në rastin e subjektit të interesuar);

ii) marrëveshjen e qirasë apo të zhvillimit të lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhënësit (vetëm në rastin e personit të stimuluar);

iii) lejen e ndërtimit për njësinë e ndërtuar (vetëm në rastin e personit të stimuluar);

iv) planimetrinë dhe sipërfaqen në m^2 të njësisë së ndërtuar;

v) dokumentet e pronësisë për njësinë e ndërtuar, nëse ka;

vi) kopje të dokumentit të identifikimit ose ekstrakt të regjistrit tregtar.

f) Nënshkrimin, adresën e subjektit të interesuar/personit të stimuluar, si dhe një numër kontakti.

2. Kërkesat për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, shoqërohen nga dokumentacioni financiar që vërteton shlyerjen e tarifës së aplikimit dhe paraqiten pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t, ku regjistrohen.

3. Të dhënat e përftuara nga administrimi i kërkesave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, pasqyrohen në formularin e të dhënave, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, i cili plotësohet, administrohet dhe ruhet nga një format dixhital.

4. Formulari i të dhënave do të përmbajë elemente që lidhen me:

a) Datën e paraqitjes së kërkesës.

b) Të dhëna mbi personin e stimuluar, apo gjeneralitetet e subjekteve të interesuara.

c) Të dhënat e tipit të marrëveshjes së lidhur me qiradhënësin.

d) Adresën e zonës së stimuluar/njësisë së ndërtuar.

e) Të dhënat e gjendjes ndërtimore të njësisë së ndërtuar.

f) Indeksin e dokumentacionit të pronësisë që disponohet për njësinë e ndërtuar.

g) Të dhëna të tjera të karakterit ndihmës.

5. Të dhënat e mbledhura shërbejnë për verifikimin e gjendjes juridike dhe në terren të truallit të njësive ndërtimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

FORMULARI I TË DHËNAVE TË NJËSISË SËNDËRTUAR

DATA E PARAQITJES SË KËRKESËS	SUBJEKTI I INTERESUAR	PERSONI I STIMULUAR	TIPI I MARRËVESHJES QIRAJE; ZHVILLIMI; QIRAJE+ ZHVILLIMI	EMËRTIMI I ZONËS SË STIMULUAR/NJËSISË SË NDËRTUAR DHE VENDNDODHJA	TË DHËNAT E NJËSISE SË NDËRTUAR					INDEKSI I DOKUMENT. TE PRONËSISË	NR. KONTAKTI
					Sipërfaqja e bazës	Sipërfaqja e ndërtimit	Numri i kateve	Funksioni	Sipërfaqja që kërkohet		

FORMULARI 1

KËRKESË

PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN E NJËSISË SË NDËRTUAR

SUBJEKTI I INTERESUAR 1)_____
Emër Mbiemër
2)_____
Emër Mbiemër

EMËRTIMI I ZONËS SË STIMULUAR DHE VENDNDODHJA E NJËSISË SË NDËRTUAR
_____

TË DHËNAT E NJËSISË SË NDËRTUAR

Sipërfaqja e bazës së njësisë së ndërtuar_____m^2
Sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar _____ m^2
Numri i kateve__ dhe funksioni i njësisë së ndërtuar _____
Sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë_____m^2

Bashkëlidhur kërkesës gjendet:

1.Kontrata e lidhur me personin e stimuluar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar □
2.Planimetria e njësisë së ndërtuar □
3.Dokument pronësie për njësinë e ndërtuar □
4.Dokument identifikimi ose ekstrakt i regjistrit tregtar □

Data_____/_____

_____
Emër Mbiemër Firmë

Adresa e kërkuesit_____ Numër kontakti_____

FORMULARI 2

KËRKESË

PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN E NJËSISË SË NDËRTUAR

PERSONI I STIMULUAR

1)_____

Emër Mbiemër

2)_____

Emër Mbiemër

MARRËVESHJA E QIRASË/ZHVILLIMIT NR_____DATË_____/_____
NR_____DATË_____/_____

TË DHËNAT E NJËSISË SË NDËRTUAR

Emërtimi i zonës së stimular dhe vendndodhja_____
Sipërfaqja e bazës së njësisë së ndërtuar _____m^2
Sipërfaqja e përgjithshme e njësisë së ndërtuar_____ m^2
Numri i kateve_dhe funksioni i njësisë së ndërtuar_____
Sipërfaqja e truallit për të cilën kërkohet kalimi i pronësisë_____ m^2

Bashkëlidhur kërkesës gjendet:

1.Marrëveshja e qirasë dhe/ose zhvillimit □
2.Leja e ndërtimit të njësisë së ndërtuar □
3.Planimetria e njësisë së ndërtuar □
4.Dokument pronësie për njësinë e ndërtuar □
5.Dokument identifikimi ose ekstrakt i regjistrit tregtar □

Data_____/_____

_____
Emër Mbiemër Firmë

Adresa e kërkuesit_____Numër kontakti_____